



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE

Janar – Qershor, 2017

Ky raport pasqyron funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës. Këtu janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur aktivitetet e komunave dhe trupave ndihmese të tyre, për periudhën janar - qershor 2017.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
JANAR-QERSHOR 2017

Prishtinë, Korrik 2017

HYRJE

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunat përmes organeve të veta janë të obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellët ndërmjet organeve të komunës. Organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vetë.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës, ku ka hartuar edhe këtë raport gjatë muajor lidhur me funksionimin e komunave. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës për evitimin e veprimeve komunale të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore.

Prezantimi i aktiviteteve të kuvendeve të komunave është mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësisë së komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike. Ky raport përmbledh dhe shtjellon çështjet më të rëndësishme të cilat janë në mandatin e organeve komunale, përkatësisht kuvendit të komunës dhe ekzekutivit. Fokusi kryesor është vënë në pasqyrimin e punës së kuvendeve të komunave, duke ditur se në mënyrë indirekte përfshinë edhe shpalosjen e punës së ekzekutivit, për faktin se ky i fundit i raporton Kuvendit në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga kuvendi i komunës.

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të komunave karshi mandatit ligjor që kanë.

Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të organeve të komunave, për periudhën janar-qershor 2017. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës. Kuvendi duhet të mbaj së paku 10 mbledhjeve në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

Gjatë periudhës janar – qershor 2017, në Republikën e Kosovës kanë funksionuar kuvendet e 38 komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun. Më qëllim të mbikëqyrjes së punës së kuvendeve të komunave, MAPL, ka bërë monitorimin e mbledhjeve të kuvendeve përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komunat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të tyre, komunat në masën më të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 272 mbledhje. Prej tyre 205 kanë qenë të rregullta, 36 kanë qenë jashtëzakonshme, 29 kanë qenë solemne dhe 2 urgjente.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunës:

- *Mbledhjet e rregullta, 205;*
- *Mbledhjet e jashtëzakonshme, 36;*
- *Mbledhjet solemne, 29;*
- *Mbledhje urgjente, 2.*

Komitetet e Përhershme, Komitetet Tjera dhe Komitetet Konsultative, Sipas LVL-së, kuvendet e komunave janë të obliguara të themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitetet si komitete të përhershme. Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në fusha të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete të tjera profesionale. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Kuvendi i Komunës themelon edhe komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, ato kanë qenë funksionale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave në komuna janë mbajtur gjithsej 210 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 177 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Mbledhjet e Komiteteve të Përhershme:

- *Komiteti për Politikë dhe Financa-210;*
- *Komiteti për Komunitete 177.*

Takimet Publike me Qytetarët, Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale. Komunitat janë të obliguara të vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Organizimi i takimeve publike me qytetarë ndryshon nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë. Gjatë kësaj periudhe në komunitat e Republikës së Kosovës janë mbajtur gjithsej 53 takime publike me qytetarët në 30 komuna. Në 8 komuna nuk janë mbajtur takim publike me qytetarët, si: Kllokot, Kamenicë, Novobërdë, Istog, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.

Raportimi i Kryetarit të Komunës, Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Mirëpo, ky ligj nuk ka qartësuar nëse raportet e prezantuara do t'i nënshtrohen një procesi të votimit, si dhe pasojat e mosmiratimit të tyre. Në praktikë është parë se kryetarët e komunave paraqesin me shkrim raportet në kuvendet e komunave, miratimi i të cilave është çështje e brendshme e komunave dhe pa pasoja juridike.

Forma të tjera të raportimit janë ato verbale, ku anëtarët e kuvendit parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje. Lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të paraqitur raport para anëtarëve të Kuvendit të Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë kësaj periudhe ka pasur raportime në 35 komuna, ndërsa në 3 komuna, (Leposaviq, Zveçan, Kllokot) kryetarët e komunave nuk kanë raportuar fare para Kuvendit të Komunës.

Aktet e Kuvendeve të Komunave, Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës, ndër të tjera është miratimi dhe nxjerrja e vendimeve, rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Po ashtu kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, merr vendime si dhe nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e dhura, si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë miratuar, 47 rregullore dhe 927 vendime. Nga gjithsej 974 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, 483 akte janë konfirmuar të ligjshme nga MAPL, 14 të kundërligjshme, ndërsa 477 akte janë dërguar në Ministrinë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë.

Aktet e Kuvendeve të Komunës:

- Rregullore - 47;
- Vendime - 927.

Publikimi i akteve, Një nga përgjegjësitë dhe sfidat kryesore të komunave është funksionalizimi i faqeve të komunave dhe publikimi i akteve. Pasi komunitat kanë aktivitete të ndryshme, është paraparë që futja e të dhënave në faqet komunale të jetë

e domosdoshme, ngase ju mundëson qytetarëve të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe gjendjen aktuale të komunës. Detyra për publikimin e akteve komunale është çështje e normuar me Rregulloren Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Pra, sipas kësaj Rregulloreje publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe, nga 974 akte gjithsej sa kanë miratuar kuvendet e komunave 688 janë të publikuara në web-faqet zyrtare të komunave.

1. FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Mbledhjet e kuvendeve të komunave


Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Kuvendi mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, për të miratuar aktet nënligjore të nevojshme për komunën, të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të Kuvendit të Komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.¹ Në këtë periudhë, kuvendet e komunave kanë mbajtur 272 mbledhje. Prej tyre 205 kanë qenë të rregullta, 36 kanë qenë jashtëzakonshme, 29 solemne dhe 2 urgjente.

Në vijim kemi paraqitur grafikun me numrin e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në kuvendet e komunave:

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave:

- Mbledhjet e Rregullta 205
- Mbledhjet e Jashtëzakonshme 36
- Mbledhje Solemne 29
- Mbledhjet Urgjente 2



Grafikoni 1: Mbledhjet e kuvendeve të komunave.

Siç shihet më përjashtim të Komunës së Lipjanit, të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e së paku 5 mbledhjeve në gjashtë mujorin e parë të vitit, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 43.2.

Gjatë kësaj periudhe çështjet që kanë dominuar në punën e kuvendeve të komunave kanë pasur të bëjnë me: miratimin e planit të punës së kuvendeve të komunave, shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore komunale, rishikimi i buxhetit, planet e ndryshme rregulluese urbane, dhënia e pronave të paluajtshme të komunave në shfrytëzim etj.

¹ Ligji Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Mbarëvajtja e mbledhjeve gjatë kësaj periudhe në përgjithësi ka qene konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo në disa raste janë konstatuar shkelje procedurale nga ana e MAPL-së. Në mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të mbajtur më datë 10 mars 2017 dhe Kuvendit të Komunës së Dragashit të mbajtur më datë: 23 qershor 2017, nuk janë respektuar procedurat për mbledhjen e jashtëzakonshme. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përkatësisht Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave, pas monitorimit të mbledhjeve, ka konstatuar se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 44, paragrafi 44.4, lidhur me njoftimin e publikut. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ Nr.05/2013 për Transparencë në Komuna, neni 3, paragrafi 3, përcakton se “Kryesuesi i kuvendit të Komunës, nëpërmes njësisë/zyrtarit për informim, njofton publikun së paku tri (3) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme përmes shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, mediave të shkruara dhe elektronike lokale dhe faqes zyrtare të komunës”.

Gjatë periudhës së raportimit, mbledhjet kanë qenë të hapura dhe transparente. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqes zyrtare të komunës, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik përveç dy rasteve të lartpërmendura. Sa i përket rrjedhës së mbledhjeve në të gjitha kuvendet e komunave, mbledhjet janë zhvilluar normalisht me përjashtim të kuvendeve të komunave: Mitrovicë Jugore, Deçan, Podujevë, Lipjan, Pejë, Klinë, Istog dhe Ferizaj, ku janë evidentuar disa raste të bojkotimit të mbledhjeve për arsytet e poshtëshënuara:

- Në Komunën e Mitrovicës Jugore, anëtarët e Kuvendit nga radhët e PDK-së, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2017, për shkak të mos përfshirjes në rend dite të një propozimi të ardhur nga ana e tyre, kanë lëshuar mbledhjen e Kuvendit.
- Në Komunën e Ferizajt në mbledhjen e mbajtur më datë: 12 maj 2017, anëtarët e Kuvendit nga radhët e PDK-së kanë lëshuar mbledhjen me arsyetimin se janë paraparë shumë pika të rendit të ditës si dhe gjatë dërgimit të ftesës dhe materialit për mbledhje nuk ka qenë koha e mjaftueshme për shqyrtimin e materialit nga anëtarët e Kuvendit.
- Në Komunën e Deçanit në mbledhjen e mbajtur më datë: 26 maj 2017, anëtarët e Kuvendit nga radhët e LDK-së kanë lëshuar mbledhjen pasi nuk u përkrah kërkesa e tyre për largim nga rendi i ditës i 4 pikave të parapara për shqyrtim.
- Në Komunën e Istogut në mbledhjen e mbajtur me datë 28 prill 2017, anëtarët e Kuvendit nga radhët e opozitës kërkuar që 4 pika të rendit të ditës që kishin të bënin me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të hiqen nga rendi i ditës, për arsye të mos përgatitjes së materialit për këto pika ashtu siç parashihet më LVL. Megjithatë propozimi i tyre nuk kaloi, ata lëshuan mbledhjen e Kuvendit.
- Në Komunën e Klinës në mbledhjen e mbajtur më datë: 28 prill 2017, opozita ka lëshuar mbledhjen e Kuvendit për arsye të vonës së fillimit të mbledhjes për shkak të problemeve teknike (prishje ne rrjetin elektrik në sallën e Kuvendit).
- Në Komunën e Pejës në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur me datë: 31 janar 2017, pas votimit për Rregulloren Nr.01/2017 për kushtet dhe kriteret e ndarjes së subvencioneve, mbledhjen e kanë lëshuar anëtarët e subjekteve politike, AAK-së dhe LVV-së, në shenjë pakënaqësie për mënyrën e votimit të kësaj rregulloreje. Po ashtu në mbledhjen e mbajtur me datë: 03 mars 2017, anëtarët e Kuvendit nga radhët e

AAK-së, lëshuan mbledhjen e Kuvendit në shenjë pakënaqësie me vendimin për burgosjen e z.Ramush Haradinaj nga autoritetet Franceze.

- *Gjatë kësaj periudhe është shënuar një bojkotim i mbledhjes në Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga ana e opozitës ku në shenjë pakënaqësie e ka lëshuar mbledhjen.*

Lidhur me mbarëvajtjen e mbledhjeve, gjatë kësaj periudhe problem të theksuara ka pasur në funksionimin e Kuvendit të Komunës së Lipjanit. Që nga marsi i këtij viti të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Lipjanit nuk janë mbajtur si rezultat i mungesës së kuorumit. Në këtë komunë janë evidentuar pesë raste të bojkotimit të mbledhjes nga opozita:

1. *Mbledhja e thirrur me datë: 01 mars 2017;*
2. *Mbledhja e thirrur me datë: 29 mars 2017;*
3. *Mbledhja e thirrur me datë: 02 maj 2017;*
4. *Mbledhja e thirrur me datë: 25 maj 2017, dhe*
5. *Mbledhja e jashtëzakonshme e thirrur me datë: 26qershor 2017.*

Bojkotimi i këtyre mbledhjeve nga radha e opozitës fillimisht vjen si rezultat i prishjes së koalicionit të partive politike të cilat qeverisnin në këtë Komunë, si dhe mos marrjes parasysh të kërkesës së opozitës për hedhjen në votim si pikë shtesë edhe pikën “ Votëbesimi i Kryesueses së Kuvendit të Komunës”.

Për gjendjen e krijuar në këtë komunë janë dërguar dy shkresa njoftuese nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:

1. *Shkresën Nr.0-519/1, datë 20.04.2017 për ecurinë e seancës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit të mbajtur me datë 29.03.2017, dhe*
2. *Shkresa Nr.0-519/2, datë 04.05.2017 për iniciativën e disa anëtarëve të Kuvendit të Komunës për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.*

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, përveç komunës së Junikut, Mamushës dhe Dragashit të cilat në disa raste për shkak të problemeve teknike nuk ka pasur mundësi me i dërgua me kohë materialet për mbledhje të gjitha komunat tjera e kanë kryer këtë obligim ligjor në raport me MAPL-në. Megjithatë, disa komuna kanë dështuar që së bashku me ftesën për mbledhje të dërgojnë në organin mbikëqyrës edhe materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si komunat: Partesh, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviqi.

Duke ditur se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është organ mbikëqyrës i komunave, për ato kompetenca të komunave për të cilat me ligji nuk i'u ka dhënë detyrimin ligjor për mbikëqyrje një ministrie sektoriale, është hartuar plani gjithëpërfshirës i monitorimit të komunave. Monitorimi i komunave në këtë segment është realizuar deri më tani në 18 komuna dhe është bërë përmes metodës së vërtetimit me pjesëmarrje, ku kemi pasur qasje në dokumentet zyrtare relevante për qëllimin e monitorimit. Ndërsa, si pjesë kryesore e metodologjisë së përcaktuar kanë qenë edhe takimet me Nënkryetar të Komunave, Kryesues të Kuvendeve të Komunave, Drejtorët e drejtorive të komunave dhe kontaktet me zyrtarët përkatës


komunal, ku përmes bashkëbisedimit rreth problemeve është synuar të realizohet një hulumtim kualitativ i ngecjeve dhe të arriturave të komunave nga aspekti i zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Ky planë i cili ka pasur për qëllim që organet e komunave të monitorohen në raport me përmbushjen e obligimeve ligjore, ka paraparë 6 objektiva:

1. Monitorimi i funksionimit të organeve të komunës në zbatimit të legjislacionit - rishqyrtimi i akteve të kundërligjshme;
2. Menaxhimi i pronës komunale;
3. Transparenca komunale;
4. Të drejtat e njeriut;
5. Integritet Evropiane;
6. Bashkëpunimi Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar.

KOMITETET E PËRHERSHME

Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e përhershme për të mbështetur punën e tyre. Komunitet janë të obliguara të themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitet si komitete të përhershme. Si rregull, mbledhjet e komiteve mbahen para mbledhjeve të kuvendeve, duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Megjithatë, vërejmë se komitetet për komunitete në këtë gjashtëmujor janë treguar më pak aktive në krahasim me mbledhjet e kuvendeve të komunave. Numri i takimeve të komiteve të obligueshme është paraqitur si në vijim:



Grafikoni 2: Mbledhjet e komiteve të përhershme.

Në total, Komitetet për Politikë dhe Financa në komuna kanë mbajtur 210 takime, kurse Komitetet për Komunitete 177 takime. Krahasuar aktivitetin e tyre, shihet se komiteti për komunitete ka mbajtur 33 takime më pak se sa Komiteti për politikë dhe financa.

Komitetet Konsultative, Kuvendi i Komunës në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 73, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteve Konsultative në Komuna, është i obliguar të themelojë edhe Komitetet Konsultative me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.. Edhe pse themelimi i tyre është i obligueshëm, numri i komunave të cilat kanë themeluar këto komitete është i vogël.

Janë themeluar gjithsej 34 komitete konsultative. Në fushën e planifikimit hapësinor (Mitrovicë Jugore, Gjilan, Vushtrri); në fushën e arsimit (Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj, Vushtrri, Glllogoc); në fushën zhvillimit ekonomik (Kamenicë, Vushtrri, Hani i Elezit, Ferizaj, Glllogoc); në fushën e urbanizmit (Ferizaj, Vushtrri); në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (Mitrovicë Jugore, Vushtrri, Glllogoc); në fushën e shërbimeve publike (Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Vushtrri); në fushën personat me aftësi të kufizuara (Mitrovicë Jugore); në fushën çështjet emergjente (Kamenicë, Hani i Elezit); në fushë e kulturës rini dhe sport (Kamenicë, Vushtrri, Hani i Elezit, Ferizaj, Mitrovicë Jugore); në fushën e administratës (Ferizaj); në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore (Vushtrri, Glllogoc).


Komitetet Tjera, Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themelojë komitete të tjera të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj.

Në komuna janë themeluar gjithsej 62 komitete të tjera, prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për shëndetësi, arsim dhe në fushën e urbanizmit. Megjithatë, në pak raste është vërejtur se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme.

TAKIMET PUBLIKE MË QYTETARËT

Komunat si njësi të vetëqeverisëse lokale duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68, janë të obliguara të vënë në funksion takimet publike, si parime bazë të komunikimit drejtpërdrejtë me qytetarë, ku secili person apo organizatë me interes ka të drejtë të marr pjesë. Kuvendi i Komunës përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë njofton qytetarët e komunës së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit ku njoftimi përmban datën, kohën, vendin e mbajtjes së takimit dhe rendin e ditës.

Komunat gjatë kësaj periudhe janë kujdesur të respektojnë rregullat për njoftimin e qytetarëve me rastin e diskutimeve publike. Për më tepër, ueb-faqet zyrtare të komunave në vazhdimësi kanë qenë transparentë duke njoftuar me kohë lidhur me aktivitetet e komunave për takimet publike. Të dhënat e në vijim tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë për periudhën raportuese janar-qershor 2017:




Grafikoni 3: Takimet publike me qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës janë mbajtur gjithsej 53 takime publike me qytetarët në 32 komuna. Komunat të cilat kanë mbajtur dy e më tepër takime publike janë: Partesh, Viti, Graçanicë, Hani i Elezit, Gjakova, Prizreni, Podujevë, Prishtinë, Shtërpcë, Suharekë dhe Gjilan, ndërsa komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarët, janë komuna e Klllokotit, Istogut, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zvečan dhe Zubin Potok.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS PËR SITUATËN EKONOMIKO-FINANCIARE

Përveç përgjegjësi të tjera të përcaktuara më legjislacionin për vetëqeverisje lokale, Kryetari i Komunës, ka përgjegjësi të raportoje para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese në komunën përkatëse. Kjo përgjegjësi duhet të përmbushet së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës, konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 58, pika j. Raportimi i Kryetarit është formë e bashkëpunimit me Kuvendin e Komunës dhe mundëson funksionimin dhe bashkëpunimin e mirëfilltë të dy organeve të Komunës. Nga të dhënat e mbledhura për numrin e raportimeve të kryetarëve në kuvendet e komunave, më hollësisht kemi paraqitur përmes grafikunit si vijon:




Grafikoni 4: Raportimi i kryetarëve të komunave.

Nga figura e mësipërme shihet se në 35 komunat, kryetarët kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për raportim para Kuvendit të Komunës së paku një herë në gjashtë muaj ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 58 pika j. Lidhur më këtë, në 3 komuna, (Leposaviq, Zveçan, Klllokot) kryetarët nuk kanë raportuar fare para Kuvendit të Komunës.

AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës, ndër të tjera është miratimi i rregulloreve dhe vendimeve për zbatimin e legjislacionit sektorial që prek kompetencat e komunave. Komunitat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore, që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret janë: miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike etj. Nga gjithsej 974 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, 483 akte janë konfirmuar të ligjshme nga MAPL, 14 akte të kundërligjshme, ndërsa 477 akte janë dërguar në Ministritë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë.

Aktet e kuvendeve të komunave




Grafikoni 5: Aktet e kuvendeve të komunave.

PUBLIKIMI I AKTEVE TË KOMUNAVE

Një nga përgjegjësitë dhe sfidat kryesore të komunave është funksionalizimi i web-faqeve të komunave dhe publikimi i akteve të miratuara. Pasi komunitat kanë aktivitete të ndryshme, është paraparë që publikimi i informatave në web-faqet komunale të jetë e domosdoshme, ngase ju mundëson qytetarëve të jenë të informuar lidhur me aktivitetet dhe punën e organeve të komunave.

Detyrimi për publikimin e akteve komunale është çështje e normuar me Rregulloren Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Pra, sipas kësaj Rregulloreje publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe, nga 974 akte gjithsej sa kanë miratuar kuvendet e komunave, 688 janë të publikuara në ëeb-faqet zyrtare të komunave.

Në vijim kemi paraqitur grafikonin lidhur me aktet e miratuara nga kuvendet e komunave dhe të publikuara në faqet zyrtare të komunës.



Grafikoni 6: Publikimi i akteve të kuvendeve të komunave.

Siç shihet nga grafikoni më lartë komunat të cilat kanë publikuar të gjitha aktet e kuvendeve të komunave janë si vijon: Gillogoc, Gjilan, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Viti, Vushtrri, Malishevë, dhe Hani i Elezit. Komunat të cilat kanë publikuar aktet pjesërisht, janë: Deçan, Dragash, Prizren, Graçanicë. Ndërsa komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë akt të miratuar brenda periudhës raportuese janë: Gjakovë, Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Junik, Mamushë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Ferizaj dhe Klllokot.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE


MAPL, është autoriteti mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe me këtë është shfuqizuar vendimi nr. 2/119 e qeveris i datës 7 Prill 2010.

Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor. Nga gjithsej 974 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, 483 akte janë konfirmuar të ligjshme nga MAPL, 14 akte të kundërligjshme, ndërsa 477 akte janë dërguar në Ministrinë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë nga të cilat.

SHKELJET LIGJORE NË KOMUNA TË EVIDENTUARA NGA MAPL

Gjatë monitorimit të komunave për periudhën janar-qershor 2017, si dhe vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale nga niveli qendror gjithsejtë janë konstatuar 39 shkelje ligjore nga niveli qendror. Nga këto, 14 shkelje ligjore janë konstatuar nga MAPL, ndërsa 25 shkelje tjera kanë konstatuar ministritë të cilat kanë qenë kompetente për vlerësimin e akteve të komunave si MMPH, MF, MBZHR etj.

Sa i përket rishqyrtimit dhe harmonizimit të këtyre akteve nga komunat gjatë kësaj përdhë komunat kanë harmonizuar 14 akte ndërsa 25 të tjera ende nuk janë harmonizuar me legjislacionin në fuqi ashtu siç është kërkuar nga organi mbikëqyrës.

Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve

Grafikoni 8: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave.

Nga 14 shkelje ka evidentuar nga MAPL, 6 prej tyre komunat i kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar sipas rekomandimeve të MAPL-së, ndërsa 8 akte ende nuk janë rishqyrtuar. Ndërsa, 25 shkelje tjera janë konstatuar nga ministritë e linjës, ku nga to komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 8 akte, ndërsa, 17 akte nuk janë rishqyrtuar ende nga komunat.

Natyra e shkeljeve për të cilat MAPL ka kërkuar nga komunat ti rishqyrtojnë dhe ti harmonizojnë vendimet e kuvendit është: dhënia e pronës komunale në shfrytëzim, emërimi i anëtarëve të KPF-së, miratimi i statutit të komunës, pastaj vendimet për emërtim të rrugëve si dhe shkelje procedurale në miratimin e vendimeve për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, vendimet për hartimin e planeve zhvillimore komunal, hartave zonale komunale, miratimi i planeve për menaxhimin e mbeturinave, vendimet për shpronësim, vendimet për falje të borxheve etj.

Ne vijim janë të paraqitura përmes tabelave shkeljet për secilën komunë të konstatuara nga MAPL dhe ministritë e linjës:

Shkeljet ligjore të cilat janë rishqyrtuar dhe janë harmonizuar konform kërkesave të MAPL-së

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Statut Nr. 183 i Komunës së Rahovecit	Rahovec	Harmonizuar (31.03.2017)
Vendimi Nr. 28 sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim paraprak të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të parcelave Nr.P - 72217056 - 00493 - 0, dhe Nr.P - 72217056 - 00494 - 0. për personat fizik/juridik.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendimi Nr. 29 sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim paraprak të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër për parcelat kadastrale P-72217092-02816-2, certifikata e pronësisë Nr.13934-2017 me sipërfaqe të tërësishme prej 8 m2 për personat fizik/juridik.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendimi Nr.35 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë kompanisë Fitorja SH.P.K me Nr. 70410455 me pronarë Tahir Maloku.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendim për emërtimin e rrugëve në territorin e komunës së Glllogocit	Glllogoc	Harmonizuar 31.03.2017
Vendimi 01 Nr.26/2017 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës publike për 99 vite të njësisë kadastrale nr.750-0 ZK Gurakoc-me qellim të ndërtimit të Kishës Katolike.	Istog	Harmonizuar 31.03.2017

Shkeljet ligjore të cilat nuk janë rishqyrtuar konform kërkesave të MAPL-së

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Vendimi Nr.430/17 për emërtimin e këshilltarit të kuvendit të komunës në komisionin për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve.	Graçanicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi Nr.31-4836 për zgjedhjen e një anëtarit të KPF-së	Glllogoc	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr. 060/01-504/1 për Dhënien në Shfrytëzim të Tokës Ndërtimore të Komunës së Dragashit.	Dragash	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr. 060/01-504/2 për Dhënien në Shfrytëzim të Tokës Ndërtimore të Komunës së Dragashit.	Dragash	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi i kuvendit të komunës 01 Nr.V-6 për fillimin e procedurave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë (99) vite ne konkurs publik	Deçan	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01 Nr.65/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 5 hektarë nga njësia kadastrale nr.28-1 në zonën kadastrale Cerrcë, PSHSH e mirë e fshatit për prodhimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.	Istog	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01 Nr.66/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 56799 m ² nga njësit kadastrale nr.00077-79, 00077-77, 00077-76, 00077-72, kompleksi në vendin e quajtur "Mali i Fshatit" zona kadastrale Lubozhdë, PSHSH e mirë e Shtetit, për prodhimin e	Istog	Nuk është rishqyrtuar

gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.		
Vendimi 01 Nr.68/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 6930m ² nga njësia kadastrale nr.74-6, sip.10356 m ² njësia kadastrale 256, sipërfaqe 80695 m ² njësia kadastrale 74-3, në zonën kadastrale Vrellë, PSHSH e mirë e fshatit, për prodhimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.	Istog	Nuk është rishqyrtuar

Shkeljet ligjore të cilat janë rishqyrtuar dhe janë harmonizuar konform kërkesave të Ministrive të linjës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Ministria	Vërejtje
Vendimin 01Nr.16 të datës 31.01.2017 për hapjen e shqyrtimit publik për Planin Zhvillimor Komunal për periudhën (tetëvjeçare) 2017-2025	Ferizaj	MMPH	Harmonizuar (21.03.2017)
Vendimin Nr.187 të datës 31.01.2017 për hartimin e Hartës Zonale të Komunës	Rahovec	MMPH	Harmonizuar 12.05.2017 26.04.2017
Vendimin Npi-01/21 të datës 01.02.2017 për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021	Shtime	MMPH	Harmonizuar 10.05.2017
Vendimin Nr. 41 të datës 28.02.2017 për caktimin e taksave komunale për lëshimin e lejeve ndërtimore në vitin 2017	Fushë Kosovë	MMPH	Harmonizuar 29.06.2017
Vendimin Nr.77 të datës 28.04.2017 për aprovimin e Kërkesës Nr.1539-2/17, të datës 04.04.2017 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit Nr.41, lidhure me ndryshimin e pikës dy (2) të vendimit Nr.41 të datës 15.03.2017	Fushë Kosovë	MMPH	Harmonizuar 29.06.2017
Vendimin Nr. 48 të datës 28.02.2017 për fillimin e procedurave për shpronësimin dhe caktimin e lokacionit për varreza në Fushë Kosovë	Fushë Kosovë	MMPH	Harmonizuar 28.04.2017
Propozim- Vendimin 01Nr.06-2263 të datës 30.03.2017 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Rinore në Klinë ngastra Nr.587/2 ZK Klinë	Klinë	MMPH	Harmonizuar (27.06.2017)
Vendimi nr. 353-24921 dt. 05.05.2017 për aprovimin e taksës administrative për leje ndërtimore për Komunën e Glllogocit	Glllogoc	MMPH	Harmonizuar 28.06.2017

Shkeljet ligjore të cilat nuk janë rishqyrtuar konform kërkesave të Ministrive të linjës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Ministria	Vërejtje
Nr.01-013/93 të datës 30.01.2017 për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për zona ekonomike me statusin „Parku Industrial” në fshatin Budrikë e Epërme	Viti	MMPH	Nuk është rishqyrtuar

Vendimin 01Nr.016-2042 të datës 31.01.2017 për inicimin e procedurës për hartimin e planit zhvillimor Komunal	<i>Suharekë</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01Nr.016-2027 të datës 31.01.2017 për inicimin e procedurës për hartimin e hartës zonale në Komunë	<i>Suharekë</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01Nr.06-947/2017 të datës 24.02.2017 për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Klinës 2017-2021	<i>Klinë</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01.Nr.17017 të datës 27.02.2017 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	<i>Gjilan</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01.Nr.17021 të datës 27.02.2017 për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm „Qendra-1” në Gjilan	<i>Gjilan</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin për hartimin e Hartës zonale 2017-2025	<i>Gjakovë</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01Nr.58 të datës 30.03.2017 për destinimin e pjesës së ngastrës kadastrale Nr.845-0 ZK Koshare me sipërfaqe prej 100m2 për ngritjen e shtatores të dëshmorit të kombit Besim Fazliu	<i>Ferizaj</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01Nr.64 të datës 30.03.2017 për zhvendosjen (dislokimin) e rrugës së pakategorizuar e cila gjendet në ngastrën kadastrale Nr.2556-2, vendi i quajtur „Mirashi i Ri” me kulturë rrugë e pakategorizuar në sipërfaqe prej 1390m2, në ngastrën kadastrale 3052-0 vendi i quajtur Mirash, në sipërfaqe të njëjtë prej 1390m2	<i>Ferizaj</i>	MMPH	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01Nr.11 të datës 31.01.2017 për faljen e borxhit në shumë prej 208.560.00 euro shoqatave të dala nga lufta dhe shoqatës të burgosurve politik që kanë komunës për shfrytëzimin e auto parkingjeve	<i>Ferizaj</i>	MF	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin Nr.01/011-31150 të datës 16.03.2017 për lejimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës së mesme të muzikës „Lorenc Antoni” në Prizren	<i>Prizren</i>	MMPH	
Vendimin 01 Nr. 65/2017 të datës 05.05.2017 sipërfaqja prej 5 hektar, nga njësia kadastrale Nr. 28-1 në zonën kadastrale Cërrcë, PSHSH e mirë e fshatit, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim	<i>Istog</i>	MBZHR	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01 Nr. 66/2017 të datës 05.05.2017 Njësitë kadastrale Nr. 0007-79;00077-76; 00077-72, kompleksi i vendit të quajtur “Mali i fshatit” Zona kadastrale Lubozhdë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 56799m2, PSH e Mirë e Shtetit, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim	<i>Istog</i>	MBZHR	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin 01 Nr. 68/2017 të datës 05.05.2017 sipërfaqja	<i>Istog</i>	MBZHR	<i>Nuk është</i>

prej 6930m2 nga ngastrat kadastrale Nr. 74-6, sipërfaqja prej 10356m2, njësia kadastrale 256, sipërfaqja prej 80695m2 njësia kadastrale 74-3, në zonën kadastrale Vrellë, PSHSH e mirë e fshatit, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim			<i>rishqyrtuar</i>
Vendimin 01 Nr. 67/2017 të datës 05.05.2017 sipërfaqja prej 11000m2 nga njësia kadastrale Nr. 74-1 në zonën kadastrale Vrellë, PSHSH e mirë e fshatit, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim	<i>Istog</i>	<i>MBZHR</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 01-350/01-0093769/17 për fillimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm për tërsin urbane “B” të lagjes “ Prishtina e Re” zona lindje	<i>Prishtinë</i>	<i>MMPH</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimin nr.01-350/01-0093751/17 për fillimin e hartimit të planit rregullues të hollësishëm të bllokut A-1 të lagjes “ Dodona”,	<i>Prishtinë</i>	<i>MMPH</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>

Rekomandimet:

- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në komunat: Klinë, Pejë, Mamushë Graçanicë, Ranillug Klllokot dhe Junik, konform Udhëzimit Administrativ Nr.2012/01 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative "TELEPREZENCAVE";
- Kryetarët e komunave: Pejë, Klinë, Istog, Podujevë, Kamenicë, Deçan, Junik, Mamushë, Shtime dhe Malishevë të dërgojnë listën e akteve të miratuara nga Kryetari i Komunës konform nenit 80.1 të LVL-së;
- Komuna e Istogut, Mitrovicës Jugore, Zveçanit, aktet e kuvendit ti hartoj konform Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave;
- Komitetet Konsultative dhe Komitete tjera të jenë më funksionale;
- Komunat të shfrytëzohet mundësia e konsultimit paraprak me autoritetin mbikëqyrës;
- Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhet të funksionon konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Të funksionalizohën web-faqet zyrtare në komunat: Klinë, Ferizaj dhe Gjakovë;
- Kuvendi i Komunës së Dragashit të njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Kuvendet e komunave: Dragash, Fushë Kosovë dhe Ferizaj të bëjë dërgimin e akteve të miratuara për vlerësim të ligjshmërisë duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar me nenin 43.5 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Në komunat: Shtime, Fushë Kosovë, Kamenicë, Klinë, Mamushë, Partesh, Klllokot dhe Graçanicë të funksionalizohën KKSBB-të, ashtu siç parashihet më nenin 11,2, të UA Nr.27-2912-03-2012 MAPL;
- Komunat: Deçan, Junik, Mamushë, Klinë, Gjakovë, Shtërpçë dhe Ranillug të bëjnë publikimin e akteve në web-faqet zyrtare të komunave, konform Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave;
- Kuvendet e komunave: Dragash, Gllogoc, Graçanicë, Istog, Viti, Suharekë, Gjakovë, Klinë, Gjilan, Prizren dhe Ferizajt, të bëjë rishqyrtimin dhe harmonizimin e akteve të vlerësuara të kundërligjshme nga MAPL, konform Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nenit 82.2.